

Sektori i Ujitjes dhe Kullimit

Misioni Bordi i Kullimit është struktura e transferuar nga Ministria e Bujqësisë ,Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave tek Bashkia Prrenjas dhe e implementuar nga kjo e fundit në strukturën e vetë organizative.

Detyrat

1. Shfrytëzon dhe mirëmban çdo sistem kullimi dhe vepër mbrojtjeje nga përmytja brenda territorit të Bashkisë Prrenjas, në mënyrë që të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit dhe të parandalojë përmytjen;
2. Merr masat e duhura për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, mbledhëse, tubave dhe strukturave.
3. Kujdeset për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të pompave të kullimit, hidrovorve;
4. Kryen çdo detyrë tjetër me urdhër të eprorit.